

ARISE

Iniciativa për Zvogëlimin e
Pabarazive në Arsim

**Udhërrëfyes Politikash
Krijimi i një mjedisi mësimor
gjithëpërfshirës dhe mbështetës
për të gjithë nxënësit**

Kosovë

Prishtinë, 2023

ARISE

Iniciativa për Zvogëlimin e Pabarazive në Arsim

Udhërrëfyes Politikash: Krijimi i një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë nxënësit

Botuesi

Qendra për Arsim e Kosovës - KEC

Kompleksi i shkollës "Mileniumi i Tretë"

Rr. Qëndresa, nr.48, Matiçan, 10000 Prishtinë, Kosovë

office@kec-ks.org

www.kec-ks.org

Për botuesin

Petrit Tahiri

Autore

Petrit Tahiri

Besjan Haziri

sipas udhëzimeve të anëtarëve të Koalicionit për Zvogëlimin e Pabarazive në Arsim

Metodologjia

Network of Education Policy Centers

Lana Jurko

Iva Perković

Dizajni

Katarina Velan

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Tabela e përmbajtjes

Sfondi	1
Rekomandimet	3
Objektivi i përgjithshëm	3
Objektivi specifik 1	3
Objektivi specifik 2	3
Objektivi specifik 3	4
Objektivi specifik 4	4
Objektivi specifik 5	4
Tabela 1. Objektivat dhe aktivitetet	5
Anëtarët e Koalicionit për Zvogëlimin e Pabarazive në Arsim	16
Referencat	18

Sfondi

Udhërrëfytyesi është hartuar në kuadër të projektit “Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim” (ARISE), një projekt rajonal i implementuar në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Turqi dhe financohet nga Komisioni Evropian.

Projekti synon të mbështesë përfshirjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik duke ndërtuar partneritete kombëtare dhe rajonale të organizatave të shoqërisë civile nga gjashtë përfituesit e lartpërmendur për t'u angazhuar në avokim dhe dialog konstruktiv për politikatat me qeveritë, për të rritur ndërgjegjësimin e akterëve të arsimit dhe ndërhyrjet pilot me fokus tek nxënësit me status të ulët socio-ekonomik në nivel shkolle.

Sipas UNESCO-s (2013), arsimi gjithëpërfshirës është “një proces i vazhdueshëm që synon ofrimin e arsimit cilësor për të gjithë duke respektuar diversitetin, nevojat dhe aftësitë e ndryshme, karakteristikat dhe pritjet e të nxënësve dhe komuniteteve, duke eliminuar të gjitha format e diskriminimit.”

Kultura shkollore gjithëpërfshirëse është një komponent kritik i një edukimi të tillë, duke përfshirë një sërë vlerash, normash dhe praktikash që nxisin një ndjenjë përkatësie, respekti dhe pranimiti.

Për ta vërtetuar këtë, hulumtimi ka treguar se shkollat me një kulturë përfshirëse, udhëheqje administrative pozitive dhe partneritete pozitive ndërmjet familjeve dhe profesionistëve kanë rezultate pozitive për të gjithë nxënësit (Francis, Blue-Banning, Turnbull, & Haines, 2016)

Në kontekstin e Kosovës, vendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në arsim të cilësisë së lartë, pavarësisht nga raca, feja, përkatësia etnike dhe aftësia e tyre.

Kushtetuta e vendit, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsimin në Komunat e Kosovës dhe Ligji për Arsimin Parashkollor, theksojnë parimet e barazisë në sistemin arsimor (Rraci, 2021).

Këto ligje dhe rregullore kanë për qëllim adresimin e nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Megjithatë, përkundër ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, Kosova ende përballet me sfida në adresimin e nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik.

Vlerësohet se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.1% të popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme (The World Bank & Kosovo Agency of Statistics, 2019). Në këtë linjë, sipas një raporti të UNICEF-it, gati 23% e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri dhe 7% në varfëri ekstreme (UNESCO, Annual Report 2022, 2023).

Kjo mund të ketë një ndikim të madh në rezultatet mëimore të fëmijëve, pasi hulumtimi ka treguar se varfëria shpesh shoqërohet me arritje më të ulëta akademike, shkallë më të lartë të braktisjes etj. Për shembull, rezultatet e PISA 2022 treguan se nxënësit me status më të lartë socio-ekonomik ia kalonin në lexim me rreth 40 pikë nxënësve të pafavorizuar.

Për të adresuar këto sfida, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në Kosovë, ka hartuar një Strategji të Arsimit për periudhën 2022-2026 dhe planin e saj të veprimit, i cili i jep rëndësi adresimit të nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik (Ministry of Education, 2022).

Si pjesë e kësaj përpjekjeje, MASHTI ka decentralizuar kompetencat tek komunitetet për të punuar më ngushtë në adresimin e nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik.

Strategjia përfshin masa të tilla si ofrimi i burimeve dhe mbështetjes shtesë për shkollat në zonat me status të ulët socio-ekonomik, rritja e qasjes në arsimin e fëmijërisë së hershme për fëmijët me status të ulët socio-ekonomik dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për të përmirësuar arritjet akademike për nxënësit me status të ulët socio-ekonomik.

Ky dokument/udhërrëfytes do të ofrojë rekomandime konkrete për të siguruar një koordinim efektiv të mekanizmave ekzistues në nivel lokal, me fokus në adresimin e nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në sistemin arsimor të Kosovës.

Në përputhje me vizionin e UNESCO-s për arsimin gjithëpërfshirës, udhërrëfytesi synon të krijojë një kulturë shkollore që përqafton diversitetin, nxit ndjenjën e përkatësisë dhe eliminon diskriminimin.

Duke identifikuar fushat kryesore për ndërhyrje, të tilla si ngritja e kapaciteteve të mësuesve, forcimi i mekanizmave të shkollës dhe mbështetja e përpjekjeve të avokimit nga OSHC-të dhe organizatat me bazë në komunitet, ky udhërrëfytes synon të krijojë një mjedis arsimor gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë nxënësit, pavarësisht statusit të tyre socio-ekonomik.

Përmes përpjekjeve bashkëpunuese dhe veprimeve të synuara, Kosova mund të përparojë drejt arritjes së qëllimit të saj për të ofruar arsim cilësor për çdo fëmijë në vend.

Rekomandimet

Si pjesë e Projektit ARISE, u krijua një **Koalicion për politika**, i përbërë nga përfaqësues të OSHC-ve, shkollave, organizatave me bazë në komunitet, studiues/akademikë nga fusha e varfërisë, hulumtimeve rreth segregimit dhe politikëbërës/përfaqësues të qeverisë.

Ky **Udhërrëfyes Politikash** u hartua me kontributin e anëtarëve të Koalicionit, bazuar në situatën e analizuar dhe bazuar në gjetjet nga **Raporti Kombëtar** i zhvilluar në kuadër të projektit. Këtu po japim disa nga rekomandimet tona, të cilat mund të zbatohen në nivel lokal për të përmirësuar situatën.

Objektivi i përgjithshëm

Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik.

Objektivi specifik 1

Rritja e bashkëpunimit mes mësimeve për të mundësuar mjedis gjithëpërfshirës në shkolla.

Veprimi

1.1. Themelimi i një Rrjeti Mbështetës të Mësimeve

1.2. Vëzhgimi dhe Informata kthyesë nga bashkëmoshatarët

Objektivi specifik 2

Nxitja e mekanizmave monitorues dhe mentorues për të mbështetur zbatimin e politikave në nivel lokal.

Veprimi

2.1. Zbatimi i politikave që adresojnë nevojat e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik në nivel lokal

2.2. Grupet e Mbështetjes me Bazë në Shkollë për Nxënësit

Objektivi specifik 3

Përmirësimi i kulturës dhe klimës së shkollës që janë parakushte për pjesëmarrje kuptimplotë.

Veprimi

3.1. Klube jashtëshkollore gjithëpërfshirëse

3.2. Rritja e diversitetit përmes aktiviteteve të vazhdueshme

3.3. Projekte gjithëpërfshirëse të drejtuara nga nxënësit

Objektivi specifik 4

Krijimi i mjedisit për të mundësuar funksionimin kuptimplotë të mekanizmave të shkollës.

Veprimi

4.1. Seri e punëtorive për mekanizmat shkollore

4.2. Kampanja vetëdijësuese

Objektivi specifik 5

Fuqizimi i shkollave për të përdorur mjetet e planifikimit.

Veprimi

5.1. Punëtori për ngritjen e kapaciteteve për stafin e shkollës mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe mbështetjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik.

5.2. Shqyrtimi dhe rishikimi gjithëpërfshirës i Planeve Zhvillimore të Shkollave

Tabela 1. Objektivat dhe aktivitetet

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 1:	Rritja e bashkëpunimit mes mësimeve për të mundësuar mjedis gjithëpërfshirës në shkolla			
Veprimi	1.1. Themelimi i një Rrjeti Mbështetës mes Mësuesve			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Mbështetje nga administrata e shkollës;</p> <p>DKA-ja.</p>	<p>Shkollat lokale dhe mësuesit e tyre;</p> <p>OJQ-të ose organizatat me bazë në komunitet që veprojnë në fushën e arsimit.</p>	<p>Organizimi i një takimi me mësimeve të interesuar, për të shpjeguar qëllimin dhe përfitimet e rrjetit mbështetës të kolegëve;</p> <p>Inkurajimi i mësimeve nga shkolla të ndryshme për t'u bashkuar vullnetarisht dhe krijimi i një rrjeti mësimeve të interesuar për arsimin gjithëpërfshirës;</p> <p>Organizimi i takimeve të rregullta, fizike ose virtuale, për mësimeve që të ndajnë përvojat, sfidat dhe strategjitë efektive për mbështetjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik;</p> <p>Zhvillimi i punëtorive ose sesioneve joformale të trajnimit, ku mësimeve mund të zhvillojnë shkathësitë dhe njohuritë e tyre në praktikën mësimore gjithëpërfshirëse përmes sesioneve të udhëhequra nga kolegët mësimeve;</p> <p>Krijimi i një platforme ose grupi në internet për komunikim të vazhdueshëm dhe ndarje të burimeve në mes të rrjetit të mësimeve.</p>	<p>Mësimeve fitojnë njohuri të vlefshme dhe strategji praktike për të nxitur një mjedis mësimor gjithëpërfshirës.</p>	<p>Sigurimi i komunikimit të qartë për natyrën vullnetare të pjesëmarrjes, në mënyrë që të respektohet ngarkesa e punës së mësimeve;</p> <p>Inkurajimi i diskutimeve të hapura dhe jo-gjyqese për të mbajtur një atmosferë pozitive dhe mbështetëse brenda rrjetit.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 1:	Ngritja e kapaciteteve të mësimit për të mundësuar mjedis gjithëpërfshirës në shkollë			
Veprimi	1.2. Vëzhgimi dhe Feedback-u nga Kolegët			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Modelet/Shabllonet dhe mjetet e vëzhgimit;</p> <p>Protokollet bashkëpunuese të informatës kthyesë;</p> <p>Buxheti i zhvillimit profesional.</p>	<p>Administratorët e shkollave;</p> <p>Rrjetet e mësimit.</p>	<p>Krijimi i një sistemi për vëzhgimin e kolegëve nga kolegët dhe informata kthyesë mes tyre.</p>	<p>Përmirësimi i praktikave të mësimit përmes të mësuarit nga bashkëmoshatarët dhe reagimet/feedback-et konstruktive;</p> <p>Rritje e bashkëpunimit dhe e rritjes profesionale në mes mësuesve.</p>	<p>Sigurimi i një kulture besimi dhe konfidencialiteti;</p> <p>Sigurimi i udhëzimeve të qarta për vëzhgim dhe informata kthyesë;</p> <p>Nxitja e një mjedis mbështetës dhe jo-gjyqës për shkëmbimet e informatave kthyesë.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 2:	Nxitja e mekanizmave monitorues dhe mentorues për të mbështetur zbatimin e politikave në nivel lokal			
Veprimi	2.1. Zbatimi i politikave që adresojnë nevojat e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik në nivel lokal			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
Hapësirë për takime; Udhëzimet e task forcës.	DKA, organizatat me bazë në komunitet, palët e interesuara në arsim.	<p>Identifikimi i palëve kryesore të interesit nga qeverisja lokale, organizatat me bazë në komunitet dhe akterët e arsimit për të marrë pjesë në EPRMB-në komunale;</p> <p>Sigurimi i komunikimit dhe bashkëpunimit efektiv ndërmjet palëve të interesuara;</p> <p>Caktimi i takimeve të rregullta për të diskutuar progresin e zbatimit të politikave dhe për të identifikuar fushat për përmirësim.</p>	<p>Përmirësim i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet qeverisjes lokale, organizatave me bazë në komunitet dhe akterëve të arsimit;</p> <p>Monitorim dhe vlerësim i avancuar i politikave në nivel lokal;</p> <p>Rritje e efektivitetit të politikave në adresimin e nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i efektivitetit të EPRMB-ve në promovimin e zbatimit të politikave në nivel lokal;</p> <p>Ofronimi i mbështetjes dhe udhëzimeve të vazhdueshme për palët e interesuara për të siguruar zbatimin efektiv të politikave.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 2:	Nxitja e mekanizmave monitorues dhe mentorues për të mbështetur zbatimin e politikave në nivel lokal			
Veprimi	2.2. Grupe Mbështetëse të Nxënësve me Bazë në Shkollë			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Hapësirë brenda shkollave për takime grupore;</p> <p>Mbështetje nga administratorët e shkollave dhe mësimitdhënësit;</p> <p>Materiale edukative të shtypura (broshura, fletëpalosje).</p>	<p>Stafi i shkollës (mësimitdhënësit, këshilltarët, administratorët);</p> <p>Organizatata lokale.</p>	<p>Formimi i Grupeve Mbështetëse;</p> <p>Mentorimi i kolegëve;</p> <p>Takimet e rregullta grupore;</p> <p>Punëtori dhe sesione për ndërtimin e shkathësive;</p> <p>Përfshirja e prindërve;</p> <p>Monitorimi dhe gjurmimi i progresit.</p>	<p>Nxënësit me status të ulët socio-ekonomik fitojnë një ndjenjë përkatësie dhe mbështetjeje brenda mjedisit shkollor;</p> <p>Komunikim i përmirësuar midis nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve çon në një sistem mbështetës më koheziv.</p>	<p>Sigurimi i konfidencialitetit dhe krijimi i një hapësire të sigurt për nxënësit që të ndajnë përvojat dhe sfidat e tyre pa frikë nga gjykimi;</p> <p>Inkurajimi dhe komunikimi hapur me prindërit për të siguruar që mbështetja e tyre të përputhet me qëllimet e grupeve mbështetëse.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 3:	Përmirësimi i kulturës dhe klimës së shkollës që janë parakushte për pjesëmarrje kuptimplotë			
Vepimi	3.1. Klube jashtëshkollore të përfshirjes			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
Hapësira dhe ambiente shkollore të disponueshme.	DKA; Shkollat; Organizatata lokale.	Zhvillimi i takimeve për të mbledhur interesat dhe idetë e nxënësve për klubet gjithëpërfshirëse; Identifikimi i mësimeve apo stafit që dëshiron të mbikëqyrë çdo klub; Krijimi i klubeve bazuar në interesat e nxënësve (p.sh., art, muzikë, sport, letërsi); Organizimi i takimeve dhe aktiviteteve të rregullta të klubit.	Rritja e angazhimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitetet jashtëshkollore; Komunitet shkollore më gjithëpërfshirës dhe mikpritës; Bashkëpunim dhe miqësi të zgjeruara midis grupeve të ndryshme.	Sigurimi i mbështetjes dhe mbikëqyrjes së mësimeve apo stafit për të ruajtur një mjedis të sigurt; Inkurajimi i komunikimit të hapur dhe informatës kthyesë për të adresuar çdo çështje të mundshme; Adresimi i menjëhershëm i çdo rasti ekskluziviteti ose diskriminimi.

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 3:	Përmirësimi i kulturës dhe klimës së shkollës që janë parakushte për pjesëmarrje kuptimplotë			
Veprimi	3.2. Rritja e diversitetit përmes aktiviteteve të vazhdueshme			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
Hapësirat dhe ambientet shkollorë të disponueshme.	Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, anëtarët e komunitetit.	<p>Formimi i një komisioni për të planifikuar dhe organizuar aktivitetet;</p> <p>Ftesa për nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit që të shfaqin kulturat e tyre përmes prezantimeve, shfaqjeve dhe ekspozitave;</p> <p>Organizimi i punëtorive dhe aktiviteteve interaktive mbi diversitetin, përfshirjen dhe vlerësimin kulturor;</p> <p>Mbajtja e diskutimeve të hapura për nxitjen e mirëkuptimit dhe ndjeshmërisë.</p>	<p>Rritja e ndërgjegjësimit dhe vlerësimit kulturor midis nxënësve dhe stafit;</p> <p>Kuptimi dhe pranimi i i përmirësuar i prejardhjeve të ndryshme;</p> <p>Forcimi i lidhjeve të komunitetit.</p>	<p>Sigurimi i përfaqësimit të grupeve të ndryshme kulturore dhe etnike në komisionin e planifikimit;</p> <p>Adresimi i çdo shqetësimi ose pandjeshmërie të mundshme kulturore gjatë ngjarjes;</p> <p>Inkurajimi i dialogut me respekt dhe mirëkuptim i ndërsjellë gjatë diskutimeve.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 3:	Përmirësimi i kulturës dhe klimës së shkollës që janë parakushte për pjesëmarrje kuptimplotë			
Veprimi	3.3. Projekte të përfshirjes të drejtuara nga nxënësit			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
Burimet e disponueshme shkollore (p.sh. materialet, klasat).	Mësimdhënësit, nxënësit, organizatat lokale.	<p>Inkurajimi i nxënësve që të propozojnë dhe paraqesin idetë e tyre për projekte gjithëpërfshirëse;</p> <p>Ndihmë nxënësve në formimin e ekipeve të projektit dhe planifikimin e iniciativave të tyre;</p> <p>Sigurimi i udhëzimeve dhe mbështetjes gjatë zbatimit të projektit;</p> <p>Festimi dhe shfaqja e rezultateve të projekteve brenda komunitetit të shkollës.</p>	<p>Rritje e angazhimit dhe pronësisë së nxënësve në promovimin e gjithëpërfshirjes;</p> <p>Zbatimi i projekteve të ndryshme kreative të gjithëpërfshirjes;</p> <p>Ndikimi pozitiv në kulturën dhe mjedisin e shkollës.</p>	<p>Siguria që të gjitha projektet e udhëhequra nga nxënësit të përputhen me vlerat e gjithëpërfshirjes dhe të mos nxisin diskriminimin;</p> <p>Sigurimi i udhëzimeve dhe mbështetjes së nevojshme për nxënësit për të siguruar përfundimin e suksesshëm të projektit;</p> <p>Mirënjohja dhe vlerësimi i të gjitha përpjekjeve të nxënësve, pavarësisht nga rezultatet e projektit.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 4:	Krijimi i mjedisit për funksionimin kuptimplotë të mekanizmave të shkollës			
Veprimi	4.1. Seri e punëtorive për mekanizmat shkollorë			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Të dhënat e mbledhura Vlerësimi i nevojave;</p> <p>Materialet e punëtorive/udhëzimet Trajnerët / Burimet njerëzore.</p>	<p>OJQ-të;</p> <p>DKA;</p> <p>MASHTI.</p>	<p>Punëtori për vlerësimin e nevojave;</p> <p>Organizimi i trajnimeve për Bordin e Shkollës;</p> <p>Punëtori mbi rolet dhe përgjegjësitë e këshillave të prindërve;</p> <p>Punëtori mbi rolet dhe përgjegjësitë e Këshillave të Nxënësve;</p> <p>Mbështetja e prindërve nga grupet vulnerabël për të marrë pjesë aktive dhe kuptimplotë në mekanizmat e shkollës.</p>	<p>Mekanizmat e shkollës janë të gatshëm të veprojnë në mënyrë të pavarur;</p> <p>Këshilli i Prindërve është funksional;</p> <p>Këshilli i Nxënësve është aktiv.</p>	<p>Informimi i të gjitha palëve mbi rëndësinë e të qenit i përfshirë dhe të qenit aktiv në jetën shkollorë;</p> <p>Prezantimi i parimeve të qeverisjes demokratike të shkollës bazuar në udhëzimet e Komisionit Evropian;</p> <p>Pronësia e ndërhyrjes.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 4:	Krijimi i mjedisit për funksionimin kuptimplotë të mekanizmave të shkollës			
Veprimi	4.2. Kampanja vetëdijësuese			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
Fletushka; Temat e identifikuara dhe mjetet për kampanja.	OJQ-të; DKA; Komuniteti i shkollës.	Përgatitja dhe shpërndarja e fletushkave; Sesion informues për prindërit mbi metodologjitë e prindërimit; Sesion informues për nxënësit mbi antidiskriminimin, pabarazitë, bullizmin.	Komuniteti shkollor është i informuar për rolet dhe përgjegjësitë në jetën shkollore; Prindërit janë të vetëdijshëm për parimet e Disiplinës Pozitive; Nxënësit janë të informuar dhe të aftë për të trajtuar rastet e dhunës, diskriminimit dhe sjelljeve të tjera negative.	Informimi i të gjitha palëve mbi rëndësinë e të qenit i përfshirë dhe të qenit aktiv në jetën shkollore; Organizimi i takimeve formale dhe joformale me prindërit dhe partnerët e shkollës; Ndarja e përgjegjësisë.

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 5:	Fuqizimi i shkollave për të përdorur mjetet e planifikimit			
Veprimi	5.1. Punëtori për ngritjen e kapaciteteve për stafin e shkollës mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe mbështetjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Fasilitatorë të trajnuar; Materialet dhe fletushkat e punëtorive;</p> <p>Pajisje audiovizuale (projektorë, ekrane, etj.);</p> <p>Vendi për punëtori;</p> <p>Format e vlerësimit dhe të informatave kthyesë.</p>	<p>DKA; OJQ që punojnë në fushën e arsimit dhe gjithëpërfshirjes;</p> <p>Përfaqësuesit e komunitetit lokal.</p>	<p>Identifikimi dhe ftesa shkollave për të marrë pjesë në punëtori;</p> <p>Zhvillimi i përmbajtjeve të punëtorisë duke u fokusuar në arsimin gjithëpërfshirës dhe strategji për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në Planin Zhvillimor të Shkollës (PZhSh);</p> <p>Zhvillimi i punëtorive për ngritjen e kapaciteteve për stafin e shkollës, duke përfshirë mësimdhënësit, drejtorët dhe stafin mbështetës;</p> <p>Ofrimi i udhëzimeve praktike për integrimin dhe mbështetjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik në PZhSh.</p>	<p>Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive për parimet e arsimit gjithëpërfshirës tek stafi i shkollës;</p> <p>Kuptim i përmirësuar i mënyrës se si të adresohen nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik brenda PZhSh-së;</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të shkollave për të zbatuar strategji që promovojnë gjithëpërfshirjen;</p> <p>Shkollat demonstrojnë angazhim për të adresuar në mënyrë aktive nevojat e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik, në planifikimin e tyre.</p>	<p>Vlerësimi paraprak i nevojave të shkollave për të përshtatur në mënyrë efektive përmbajtjen e punëtorisë;</p> <p>Disponueshmëria e fasilitatorëve rezervë në rast të mosdisponueshmërisë së papritur;</p> <p>Mbledhja e informatave kthyesë gjatë dhe pas punëtorive për të identifikuar fushat për përmirësim.</p>

Qëllimi i politikës	Sigurimi i koordinimit të mekanizmave ekzistues në nivel lokal për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik			
Objektivi specifik 5:	Mbështetja e shkollave për të përdorur mjete planifikimi / avancimi i PSZH-së që përfshin adresimin e nevojave të ulëta të SES			
Veprimi	5.2. Shqyrtimi dhe rishikimi gjithëpërfshirës i PZSHS-së			
Burimet	Partnerët	Metodat/Aktivitetet	Rezultatet	Zvogëlimi i rrezikut
<p>Ekipi i shqyrtimit të PZShS-së (i përbërë nga ekspertë të arsimit, përfaqësues të shkollave dhe anëtarë të komunitetit);</p> <p>Të dhëna për PZSHS-në aktuale dhe efektivitetin e saj;</p> <p>Hapësira për takime dhe materiale për shqyrtim dhe rishikim;</p> <p>Burimet e komunikimit dhe shpërndarjes.</p>	<p>DKA; Administratorët e shkollave, mësuesit dhe stafi;</p> <p>Organizatat lokale dhe përfaqësuesit e komunitetit.</p>	<p>Krijimi i një ekupi rishikues të PZShS-së me ekspertizë dhe perspektiva të ndryshme;</p> <p>Mbledhja dhe analiza e të dhënave mbi PZShS-në aktuale, duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta të tij në lidhje me nevojat e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik;</p> <p>Kryerja e kërkimeve mbi strategjitë dhe qasjet e suksesshme për të adresuar nevojat e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik në arsim;</p> <p>Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e shkollave për të diskutuar gjetjet dhe për të mbledhur të dhëna për rishikim;</p> <p>Bashkërisht të zhvillohet një rishikim gjithëpërfshirës i PZShS-së që adreson nevojat specifike të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik.</p>	<p>PZShS e rishikuar që përfshin strategji specifike për të adresuar nevojat e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik;</p> <p>Qëllime të qarta dhe plane të veprimit për përmirësimin e rezultateve mësimore për nxënësit me status të ulët socio-ekonomik;</p> <p>Rritje e bashkëpunimit dhe angazhimit ndërmjet palëve të interesuara në procesin e rishikimit të PZShS-së;</p> <p>Rritje e ndërgjegjësimit për rëndësinë e adresimit të nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik në komunitetin lokal të arsimit.</p>	<p>Përfshirja e përfaqësuesve nga komunitetet me status të ulët socio-ekonomik për të siguruar që perspektivat e tyre merren parasysh;</p> <p>Komunikim i rregullt për progresin dhe përditësimet tek të gjitha palët e interesuara për të ruajtur transparencën;</p> <p>Sigurimi i përdorimit të praktikave të bazuara në prova për të rritur gjasat e suksesit.</p>

Anëtarët e Koalicionit për Zvogëlimin e Pabarazive në Arsim

EMRI DHE MBIEMRI	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
Merita Jonuzi	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Fehmi Krasniqi	Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
Enver Bajrami	Drejtoria Komunale e Arsimit, Vushtrri
Edona Shotani	Drejtoria Komunale e Arsimit, Vushtrri
Nexhat Hajrullahu	Drejtoria Komunale e Arsimit, Gjilan
Albulena Ahmeti	Drejtoria Komunale e Arsimit, Prishtina
Regjë Mulaj	OJQ Vizioni 02, Istog
Flakron Curraj	OJQ Vizioni 02, Istog
Besime Tusha	OJQ Rrjeti i Lëvizjes Paqësore (NOPM), Kamenicë
Luljeta Maliqi	OJQ Rrjeti i Lëvizjes Paqësore (NOPM), Kamenicë
Remzije Krasniqi	OJQ KAPIE
Remzije Krasniqi	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
Fitore Gashi	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
Bukureza Surdulli	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF
Antigona Uka	Qendra Kosovare për Arsim Digjital (KCDE)
Ardianë Makolli Sadiku	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Nazim Gafurri”, Prishtinë

Xhejlane Grajçevci	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Nazim Gafurri”, Prishtinë
Arbnore Ismaili	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Nazim Gafurri”, Prishtinë
Ardian Jashari	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Liria”, Vushtrri
Edina Berisha	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Liria”, Vushtrri
Daulina Zhegrova Saraçi	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Liria”, Vushtrri
Melihate Meha	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Andon Zako Çajupi”, Mitrovicë
Hanife Hamiti	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Andon Zako Çajupi”, Mitrovicë
Perihan Abdurrahmani	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Andon Zako Çajupi”, Mitrovicë
Rrezartë Mazreku	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ibrahim Mazreku”, Malishevë
Veton Kastrati	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ibrahim Mazreku”, Malishevë
Shyhrete Gashi	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ibrahim Rugova”, Obiliq
Nusret Zeka	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ibrahim Rugova”, Obiliq
Kimete Mexhuani	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ibrahim Rugova”, Obiliq
Besart Ismajli	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “E Gjelbër”, Prishtinë
Blerim Dalipi	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “E Gjelbër”, Prishtinë
Besjan Haziri	Mentor, Qendra për Arsim e Kosovës
Mjellma Brovina	Mentore, Qendra për Arsim e Kosovës

Referencat

Francis, G. L., Blue-Banning, M., Turnbull, A. P., & Haines, S. J. (2016). Culture in inclusive schools: Parental perspectives on family-school partnerships. ResearchGate.

Ministry of Education, S. T. (2022). Education Strategy 2022 - 2026. Ministry of Education, Science, Technology and Innovation (MESTI).

Rraci, E. (2021). Action for Reducing Inequalities in Education - National Report for Kosovo. Kosova Education Center.

The World Bank, & Kosovo Agency of Statistics. (2019). CONSUMPTION POVERTY IN THE REPUBLIC OF KOSOVO.

UNESCO. (2013). Inclusive Education. UNESCO.

UNESCO. (2023). Annual Report 2022. UNESCO.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

